



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŠA BELEDIYESI-KOMUNA E MAMUSHËS-OPŠTINA MAMUŠA- MUNICIPAL OF MAMUSA

Referenca: **626/19/017/236**

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Menaxherit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik **N.P.SH."BIOKS"** me numër të biznesit: **70823039**, selia në **Suharekë** i përfaqësuar nga z. **Naim Kicaj**, në cilësinë e Drejtorit (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbime si më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

Hartimi i projekteve bujqësore për fermerët e Mamushës
me numër Identifikues : **626-19-2911-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me hartimin e projekteve bujqësore për fermerët e Mamushës me qëllim të aplikimit për fitimin e granteve të ndryshme si më poshtë.

Nr	Kompletimi i dokumentacionit për aplikim ne MBPZHR Sipas udhëzimit për aplikimet e shpallur për vitin 2019	Njësia	Sasia
I	Masa: 101 - Investimet ne asetet fizike te ekonomive bujqësore:		
1	Hartimi i projektit dhe përgatitja e dokumenteve për aplikim ne MBPZHR Plotësimi I dokumenteve për aplikim sipas listës se shpallur nga AZHB për këtë mase, duke përfshi skanimin e komplet dokumentacionit dhe incizimin e CD-se		
1	Spektori I Pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka,ftoni)	Copë	2
2	Spektori I Perimeve dhe serrave	Copë	25
3	Spektori I Mishit (ndërtimi I stallës me infrastrukturë përcjellëse si, Hangari, depo për silazhe, gropa septike etj) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2
4	Spektori I Qumështit (ndërtimi I stallës me infrastrukturë përcjellëse si, Hangari, depo për silazhe, gropa septike etj) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2
5	Spektori I Rrushit (Ngritja e plantacioneve me vreshta, mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2

6	Sektori I Vezëve (ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2
II	Masa: 302 -Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i Bizneseve, nen masat:		
2.	Hartimi i projektit dhe përgatitja e dokumenteve për aplikim ne MBPZHR Plotësimi i dokumenteve për aplikim sipas listës se shpallur nga AZHB për këtë mase, duke përfshi skanimin e komplet dokumentacionit dhe incizimin e CD-se		
1	302.1 Prodhimi i mjaltit	Copë	4
2	302.2 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	Copë	1
3	302.3 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	Copë	2
4	302.4 Zhvillimi i turizmit rural	Copë	1

1.2 Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga ana e të dy palëve kontraktuese dhe është e vlefshme për periudhën prej **30** ditëve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **30 ditë** nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 **Projektet duhet të hartohen në objektet e kontraktuesit, ndërsa një kopja e fermerit do të dorëzohet në Mamushë.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **8.948,00 €;**

Tetmijë e nëntqindë e katërdhjetë e tetë Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të shërbimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit

Neni 7 Garancioni

7.1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbime kualitative për hartimin e projekteve në bazë të kërkesave të paraqitura në udhëzimin për aplikim të shpallur nga MBPZHR për vitin 2019.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje

profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Naim Kicaj	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	31.05.2019	Data:	31.05.2019
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUŠHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA




Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “Hartimi i projekteve bujqësore për fermerët e Mamushës”

Nr. i Prokurimit ¹	626-19-2911-2-3-6
Nr i brendshëm	626-19-017-2-3-6


Nr	Kompletimi i dokumentacionit për aplikim ne MBPZHR Sipas udhëzimit për aplikimet e shpallur për vitin 2019	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
I	Masa: 101 - Investimet ne asetet fizike te ekonomive bujqësore:				
1	Hartimi i projektit dhe përgatitja e dokumenteve për aplikim ne MBPZHR				
1	Plotësimi i dokumenteve për aplikim sipas listës se shpallur nga AZHB për këtë mase, duke përfshi skanimin e komplet dokumentacionit dhe incizimin e CD-se				
1	Sektori I Pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni)	Copë	2	25.00	50.00
2	Sektori I Perimeve dhe serrave	Copë	25	348.00	8,700.00
3	Sektori I Mishit (ndërtimi i stallës me infrastrukturë përcjellëse si, Hangari, depo për silazhe, gropa seprike etj) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2	50.00	100.00


¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



4	Sektor i Qumështit (ndërtimi i stallës me infrastrukturë përcjellëse si, Hangari, depo për silazhe, gropa septike etj) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2	15.00	30.00
5	Sektor i Rrushit (Ngrija e plantacioneve me vreshta, mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2	1.00	2.00
6	Sektor i Vezëve (ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut) duke përfshi edhe pjesën arkitektonike	Copë	2	1.00	2.00
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					8,884.00
II	Masa: 302 -Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i Bizneseve, nen masat:				
2.	Hartimi i projektit dhe përgatitja e dokumenteve për aplikim ne MBPZHR Plotësimi i dokumenteve për aplikim sipas listës se shpallur nga AZHB për këtë masë, duke përfshi skanimin e komplet dokumentacionit dhe incizimin e CD-se				
1	302.1 Prodhimi i mjalit	Copë	4	15.00	60.00
2	302.2 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	Copë	1	1.00	1.00
3	302.3 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	Copë	2	1.00	2.00
4	302.4 Zhvillimi i turizmit rural	Copë	1	1.00	1.00
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					64.00

REKAPITULLIM		Çmimi €
1	Masa: 101 - Investimet ne asetet fizike te ekonomive bujqësore:	8,884.00
2	Masa: 302 -Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i Bizneseve, nen masat	64.00
Gjithsejtë duke llogaritur të gjitha taksat dhe tatimet e aplikuar (1+2)		8,948.00



IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	N.P.SH. BLOKS
ADRESA E PLOTE	GREKOC, SUHAREKË
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	NAIM KICAJ
POZITA	DREJTUES LIGJOR
NËNSHKRIMI	
DATA	28.02.15
VULA	

